



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-1133

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-101012/21 dt. 03.06.2021, të pronareve Adem Ademi, Kadrush Bullatovci, Rexhep Xheladini, Musli Bajrami, Ilaz Asllani, Lulzim Bunjaku nga Prishtina, dhe investitorit NPN “Driloni Com”, me numër të biznesit 810707383 përfaqësuar nga Dalip Gashi, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+S+P+14 e ndërtuar në parcelën kadastrale nr. 10132-0 Z.K. Prishtinë, në bllokun-parcelën urbane “B-1/b_04” të tërësisë urbane “B” ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C1”, të Planit Rregullues “Muhaxhirë”, në rr. “Jashar Saliu” hyrjet nr. 79, 81, 85, 89, 95, 97 në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 21.09.2021, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Adem Ademi, Kadrush Bullatovci, Rexhep Xheladini, Musli Bajrami, Ilaz Asllani, Lulzim Bunjaku nga Prishtina, dhe investitorit NPN “Driloni Com”, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-101012/21 dt. 03.06.2021, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm 2B+S+P+14 e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-23071 dt. 30.03.2016, në parcelën kadastrale nr. 10131-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10132-0 Z.K. Prishtinë, konkretisht në bllokun-parcelën urbane “B-1/b_04” të tërësisë urbane “B” ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C1”, të Planit Rregullues “Muhaxhirë”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, të ndërtuara në rrugën “Jashar Saliu” hyrjet nr. 79, 81, 85, 89, 95, 97 në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësisë të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronareve Adem Ademi, Kadrush Bullatovci, Rexhep Xheladini, Musli Bajrami, Ilaz Asllani, Lulzim Bunjaku nga Prishtina, dhe investitorit NPN “Driloni Com”, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-101012/21 dt. 03.06.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, me etazhitet 2B+S+P+14, e ndërtuar konkretisht në bllokun-parcelën urbane “B-1/b_04” të tërësisë urbane “B” ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C1”, të Planit Rregullues “Muhaxhirë”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10131-0 ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-23071 dt. 30.03.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 6 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Veton Haxhiu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Bujar Emra; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Lavdit Sherifi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Agan Elezi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Bashkim Halabaku; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Murat Hoxha me nr. të licensës 27;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.


I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-101012/21 DT. 21.09.2021**

Zyrtari,
Arbër Morina



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi



Faqe 2 prej 2

